



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 35 Prot.

Tiranë, më 17.01.2022
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Përcillet vendimi i Bordit të Akreditimit

KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”

Rruga Jordan Misja

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të rradhës, të mbajtur më datë 16 Dhjetor 2021, mori vendim për akreditimin institucional të Kolegjit Universitar “Bedër”.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 57, datë 16.12.2021.

Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se vendimi është publikuar dhe në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTORI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI PVC**

Xhiliola Bixheku



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 57, datë 16.12.2021

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
KOLEGJI UNIVERSITAR “BEDËR”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2021, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik institucional të **institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar “Bedër”, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë: **Kolegji Universitar “Bedër”**
- b) Organizimi i institucionit: **Jopublik**
- c) Lloji i institucionit: **Kolegj Universitar**
- d) Njësitë kryesore të institucionit:
 - a. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë
 - b. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit
- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011
- f) Akti zyrtar i riorganizimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 03.07.2020
- g) Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 101, datë 10.11.2017

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga ekspertë të huaj dhe vendas;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm Institucional;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- h. Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe rezultatet e akreditimit periodik këtij institucioni të Arsimit të Lartë;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Institucioni ka ndërmarrë masa për të përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi periodik;
- e. Rezultatet e vlerësimit të akreditimit periodik janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- f. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për institucionin në fjalë;
- g. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, sipas fushave janë: Fusha 1 **“përmbushen plotësisht”**, Fusha 2 **“përmbushen plotësisht”**, Fusha 3 **“përmbushen plotësisht”**, Fusha 4 **“përmbushen kryesisht”**, Fusha 5 **“përmbushen plotësisht”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Mungesa e projekteve kërkimore shkencore me ndikim të lartë, të cilët do të mundësonin publikimin e artikujve shkencorë në revista me faktor impakti.
 2. Mungesa e një politike për shpërndarjen e fondeve për kërkimin shkencor, të cilat përdoren përgjithësisht vetëm për pjesëmarrje në konferenca.
 3. Qendra e Kërkimit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Qendra për Kërkuesit e Rinj, nuk janë aktive.
- h. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë institucion është pozitiv.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. **Vlerësimin përfundimtar POZITIV** për institucionin e arsimit të lartë, **Kolegji Universitar “Bedër”**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin institucional** të institucionit të arsimit të lartë, **Kolegji Universitar “Bedër”**, me kohëzgjatjen prej **5 (pesë) vite**.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është **15/12/2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER



Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN



Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI



Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 54, datë 16.12.2021, "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, **Kolegji Universitar "Bedër"**, janë si vijon:

1. Institucioni, të rrisë buxhetin për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor si dhe të inkurajojë publikimet nga stafi akademik në revista shkencore të indeksuara dhe me faktor impakti, duke vendosur si standard publikimin e të paktën një artikulli për staf akademik, në revista ndërkombëtare.
2. Institucioni, të hartojë një politikë për shpërndarjen e fondeve të kërkimit shkencor në mënyrë që të mundësohen projekte të reja shkencore dhe të mbështesë jo vetëm pjesëmarrjen në konferenca por dhe publikimin në revista prestigjioze.
3. Institucioni, të marrë masa për forcimin e rolit të Qendrës së Kërkimit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Qendrës për Kërkuesit e Rinj.
4. Institucioni, të rrisë numrin e stafit akademik me tituj dhe grada dhe të shmangë punësimin e stafit akademik me diplomë Master, me përjashtim të rasteve kur këta të fundit janë pjesë e një programi doktorature.
5. Institucioni, të garantojë trajnim të vazhdueshëm për stafin akademik mësimdhënës, duke ftuar staf akademik të huaj apo shqiptar nga vende jashtë Shqipërisë, si Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Europian.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar "Bedër"**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

